



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

V E N D I M

Nr. 2420, datë 06.02.2014

Për

“Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 2354, datë 27.9.2013, për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a.””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Antwtare
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj. Iris Xhanaj, në mbledhjen e datës 06.02.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”), ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shteterore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 2354, datë 27.9.2013, për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a.””.

BAZA LIGJORE:

1. Shkronja n) e nenit 8, pika 1e nenit 114, pikat 1 dhe 2 të nenit 115 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);

3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 2354, datë 27.9.2013, për “*Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a.*””.
2. Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr. 5938/1, datë 1.10.2013, drejtuar Vodafone “Mbi zbatimin e MI dhe VKD nr. 2354, datë 27.9.2013, mbi vijimin e ofrimit të shërbimit të interkoneksionit nga ana e Vodafone”.
3. Shkresa e Vodafone me Ref. LGD/0196/OX, datë 11.10.2013 (nr. 1611/5Prot. i AKEP, datë 17.10.2013), ka sjellë “*Shpjegimet e Vodafone për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve Albtelecom sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a. filluar me VKD nr. 2354, datë 27.9.2013”*”.
4. Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr. 6360Prot., datë 11.10.2013 “*Depozitimi i pretendimeve të Albtelecom sh.a. në zbatim të vendimit të AKEP nr. 2354, datë 27.9.2013, për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a.*””.
5. Shkresa e Nisatel sh.p.k. me nr. 5010/2Prot. datë 5.10.2013 (nr. 1678Prot.i AKEP, datë 9.10.2013) “*Mbi kundërshtimin e Vendimit të AKEP nr. 2354, datë 27.9.2013*”.
6. Raporti shpjegues mbi Projekt-Vendimin (*Raporti*),
si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N :

- I. AKEP me anë të Vendimit nr. 2354, datë 27.9.2013, për “*Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve Albtelecom sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a.*”, pas shqyrtimit të këtij vendimi, vëren se në pikat 1, 3 dhe 4 të tij ka vendosur:
 - *Të fillojë procedimin administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve Albtelecom sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a.*”;
 - *Të njoftohen palët e interesuara Albtelecom sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a. për fillimin e procedimit administrativ;*
 - *Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit*”;

- II. Në zbatim të VKD nr. 2354, Vodafone me shkresën me Ref. LGD/0196/OX, datë 11.10.2013 (nr. 1611/5Prot. i AKEP, datë 17.10.2013), ka sjellë “Shpjegimet e Vodafone për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve Albtelecom sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a. filluar me VKD nr. 2354, datë 27.9.2013”.

i. Në lidhje me VKD nr. 2362, Vodafone shpjegon si më poshtë:

1. Vodafone nuk ka depozituar asnjë kërkesë ankimore ndaj VKD 2354 në kuptimin e KPrA nenet 135 e në vijim, sic e ka cilësuar dhe trajtuar AKEP. Vodafone i ka kërkuar AKEP rishikimin e aktit dhe që AKEP me nismën e tij të deklarojë VKD 2354 si absolutisht të pavlefshëm.
2. Vodafone, në bazë të parimeve të KPrA (nenet, 116, 117 e në vijim) nuk mund të ankimojë apo të paraqesë një kërkesë ankimore ndaj një akti të cilin e ka cilësuar që në fillim si absolutisht të pavlefshëm dhe aq më tepër nuk mund të ankimohet te organi që e ka nxjerrë vetë aktin.
3. Për këto arsye Vodafone për asnjë cast nuk është shprehur ndaj AKEP në shkresën e datës 4.10.2013 nr. CEO/118/MF me kërkesë, ankim apo ‘kërkesë ankimore’ ndaj një akti i cili në vetvete është absolutisht i pavlefshëm, pasi për këtë qëllim Vodafone i është drejtuar Gjykatës kompetete.
4. Në përmbajtjen e VKD nr. 2362 është paragjykimi i mosmarrëveshjes mes dy sipërmarrësve nga AKEP. AKEP, në shkelje të rëndë të parimeve kushtetuese dhe administrative: parimin e ligjshmërisë, paanësisë, drejtësisë dhe barazisë (KPrA nenet 9, 11 dhe 12). Konkretisht, AKEP është shprehur dhe ka konfirmuar qëndrimin e tij paragjykes për:
 - Të detyruar palët të lidhin një marrëveshje për shërbimin e trafikut hyrës ndërkombëtar sipas kushteve që kërkon pala ankimuese Albtelecom, dhe në kundërshti me kushtet që kërkon pala e ankimuar Vodafone, kur nuk jemi në kushtet e neneve 45, 49 dhe 60 të Ligjit 9918.
 - Marrëveshja tregtare e interkoneksionit mes palëve për këtë shërbim ka përfunduar dhe AKEP i detyron palët të lidhin një marrëveshje të re tregtare përtej interesit të njëjës palë, me terma të detyruara dhe aspak komerciale, duke vendosur haptazi në favor të palës tjetër, dhe duke paragjykuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes për të vendosur në favor të Albtelecom ende pa dëgjuar parashtrimet e Vodafone.
 - Vazhdimin e masës së ndërmjetme, duke rikonfirmuar qëndrimin antiligjor duke ndërhyrë në një marrëdhënie tregtare jashtë rregullimit dhe diskriminimin e hapur në favor të Albtelecom për një interes publik që jo vetëm nuk ekziston, por për asnjë cast të vetëm nuk është analizuar dhe justifikuar nga AKEP qoftë në VKD 2354 dhe qoftë në VKD 2362.
5. AKEP në përgjigjen që i ka dhënë shkresës së Vodafone Albania është përpjekur të gjejë atribut dhe kompetencë të parimi i pushtetit diskrecional të cilin pretendon se i buron nga Kodi i Procedurave Administrative dhe Ligji, për të justifikuar veprimin e paligjshëm të ndërhyrjes në një marrëdhënie tërësisht private dhe jashtë kompetencës lëndore (funktionale) të kontrollit dhe rregullimit të AKEP.

ii. Në lidhje me VKD nr. 2354, Vodafone shpjegon se:

1. Vendimi i AKEP në tërësinë e tij është marrë në kapërcim të kompetencave që Ligji nr.9918, i ndryshuar, i jep këtij organi.
6. AKEP, me VKD nr.1741, VKD nr. 2118 dhe VKD nr. 2122 , ka vendosur që e drejta për akses dhe tarifa e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin e Vodafone, të tranzituara nga operatorë vendas të jetë jashtë rregullimit dhe “aksesi dhe tarifa e terminimit për trafikun hyrës ndërkombëtar është objekt i negociatave tregtare ndërmjet palëve” duke filluar nga data 1.9.2012.
7. Njëkohësisht AKEP nëpërmjet Vendimit nr. 2122, nuk e konsideron Vodafone si operator FNT në lidhje me terminimin e thirrjeve ndërkombëtare.
8. Vodafone thekson se ka një shmangie të qëllimshme nga AKEP në Vendimet e tij 2354 dhe 2362 për t’i bërë referencë lirisë tregtare që gëzon Vodafone për dhënie aksesit ose jo në këtë shërbim, dhe fshihet vetëm mbas tarifës së dhënë.
9. Vodafone shpjegon se, AKEP në përputhje me ligjin 9918 (nenet 45, 49 dhe 60) nuk mund të detyrojë Vodafone që të lidhë një marrëveshje aksesit ose interkoneksioni për këtë shërbim dhe për sa kohë palët a) nuk janë FNT, b) tregu është i de-rregulluar dhe c) AKEP e ka zhveshur veten nga ky atribut, ashtu sic edhe përcaktohet në Rregulloren për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve (VKD nr 1296/2010). AKEP duhet të ishte shprehur menjëherë për moskompetencën e tij dhe nuk duhet të kishte pranuar fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Vodafone dhe Albtelecom.
10. Vodafone shprehet se ndërhyrja e AKEP kur mosmarrëveshja ka të bëjë me nivelin e tarifave, madje dhe me të drejtën për të dhënë akses ose jo, që aplikohen bazuar në marrëveshjen e vetë palëve në konflikt, është përtej kufirit të kompetencës lëndore që i ka dhënë ligji, pasi AKEP në mënyrë eksplicite ka hequr dorë nga ushtrimi i të drejtës së kontrollit dhe rregullimit të këtij tregu.
11. Vodafone shpjegon se, gjithashtu edhe në MI nenet 19.6 dhe neni 34 përcaktohet qartësisht mungesa e kompetencës së AKEP në çështjet që kanë të bëjnë me pagesat. Edhe parashikimet e nenit 334 të KPrC qartësisht zhveshin AKEP nga cdo e drejtë për t’u investuar dhe për të shqyrtuar mosmarrëveshje të kësaj natyre si jashtë kompetencës së tij.
12. Kompetenca është e drejta dhe njëkohësisht detyrimi i organit të administratës publike për të kryer funksionet e tij në përputhje me ligjin. Sa më sipër sanksionohet edhe nga parimi i ligjshmërisë, i përcaktuar në nenin 9.1 të KPrA;
13. Kompetenca përbën kushtin themelor të vlefshmërisë së një akti administrativ, mungesa apo tejkalimi i së cilës pasjell pavlefshmërinë absolute të tij, siç parashikohet edhe në nenin 116, shkronja “b” të KPrA. Veprimi i AKEP në nxjerrjen e një akti administrativ, në një moment kur vetë AKEP ia ka hequr vetes këtë të drejtë, e cilëson si absolutisht te pavlefshëm këtë akt, si i nxjerrë në tejkalim të kompetencave. Një akt absolutisht i pavlefshëm nuk prodhon asnjë pasojë juridike (shih nenin 117 të KPrA).
14. Masa e ndërmjetme e marrë nga AKEP është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm pasi është marrë jo vetëm në tejkalim të kompetencave të AKEP por edhe në shkelje flagrante të ligjit

Sipas Vodafone, masa e ndërmjetme nuk plotëson asnjë prej kriterëve rigoroze të përcaktuara në nenin 78 të KPrA:

- a) Organi i marrjes së masës së ndërmjetme nuk është kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar;
 - b) Nuk çenohet aspak interesi publik dhe dëmi i supozuar, jo vetëm që nuk është i rëndë dhe i pariparueshëm, por ai nuk ekziston.
15. Vodafone shprehet se, në marrjen e masës, por edhe në mbrojtjen e saj nëpërmjet VKD 2362, AKEP është njaftuar vetëm duke thënë se potencialisht mosmarrëveshja çënon interesin publik. Në kundërshtim me nenin 78/2 të KPrA, AKEP nuk ka bërë as analizën më të vogël për të justifikuar se cili është pikërisht ky interes publik që çënohet.
 16. Vodafone shpjegon se, nëse një portë tranzitimi është mbyllur, tranzitimi i thirrjeve devijohet në kohë reale në një portë tjetër tranzitimi – kjo ndodh menjëherë pasi është në interesin e drejtpërdrejtë të operatorit dërgues dhe operatorit pritës të thirrjeve (në këtë rast Vodafone) që të marrin thirrjet dhe ti dorëzojnë ato të pajtimtarët pritës fundorë;
 17. Për të argumentuar këtë Vodafone ka paraqitur një skemë të rrugëzimit të thirrjeve ndërkombëtare.
 18. Vodafone sqaron se, nëse porta e tranzitimit të thirrjeve të Albtelecom që ka me Vodafone është e mbyllur, thirrjet që nevojiten të tranzitohen dhe terminohen në rrjetin e Vodafone kalohen menjëherë në kohë reale nëpër operatorë tranzitues të tjerë, dhe operatorë të tillë që ofrojnë tranzitim ka me dhjetra në treg. Roli i Albtelecom në këtë proces nuk është thelbësor dhe për më tepër marrëdhënia origjinim–terminim nuk çënon për asnjë cast pajtimtarët e Albtelecom.
 19. Sipas Vodafone, nuk ekziston çënim i interesit publik për palët e origjinuara vetë operatorit origjinues është palë e interesuar për të përcjellë thirrjen nga një pajtimtar fillestar i tij (*origjinues jashtë territorit të Shqipërisë*) të pajtimtari fundor i Vodafone (*brenda territorit Shqiptar*) dhe gjen porta alternative tranzitimi menjëherë sapo njera porte nuk është e disponueshme, ndaj cdo nderhyrje e Albtelecom me pretendimin e mbrojtjes së interesave “te botes” është plotësisht e paqene dhe absurd.
 20. Masa e marrë nga AKEP nëpërmjet VKD nr. 2354 është në dëm të interesave legjitime tregtare të Vodafone.
 21. Vodafone shpjegon se, kufizimi i lirisë ekonomike bëhet vetëm ligj (neni 11 i Kushtetutes), dhe AKEP s’ka asnjë të drejtë ligjore që nëpërmjet një akti të ndërmjetëm të kufizojë lirinë ekonomike të palëve në një marrëdhënie që vetë AKEP e ka legjitimuar si plotësisht tregtare, e për më tepër t’i detyrojë ato të rilidhin një marrëveshje që ishte ndërprerë tanimë.
 22. Në sqarimet e tij Vodafone i referohet Vendimit Unifikues të Gjykatës së Lartë N.10, datë 24/03/2004 në çështjen Civile Eden Vs Albtelecom sh.a., dhe citon pjesë të arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë. Në një vendimarrje që synon marrjen e masave provizore, autoriteti që urdheron këto masa duhet të ballancojë interesat e palëve.
 23. Vodafone shprehet se në asnjë rast tjetër analog AKEP nuk ka marrë ndonjë masë të tillë, që jo vetëm minon sigurinë juridike të palëve në proces, por dëshmon dhe njëherë se nuk ekziston dëm dhe aq me pak ai të jete i rëndë dhe i pariparueshëm.

iii. Mbi mosmarrëveshjen Vodafone dhe Albtelecom

24. Vodafone sqaron se nëpërmjet Amendamentit nr. 1 palët kanë rënë dakord që në Aneksin 2, seksioni 2.3/2.3.1.2 të MI, përsa i takon shërbimit të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituara nga rrjeti i Albtelecom drejt abonentëve të rrjetit të Vodafone Albania (Shërbimi 102), të përfshihet pika “e” me përmbajtjen: “Vodafone Albania ka të drejtën e ndryshimit të tarifave me një njoftim paraparak 7 (shtatë) ditor dërguar me shkrim Albtelecom”. Po ashtu, në Amendamentin nr. 3 palët kanë rënë dakord që neni 7, pika 7.2 e Marrëveshjes së Interkoneksionit të ndryshohet si më poshtë: “Tarifën e shërbimit të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituara nga rrjeti i Albtelecom drejt abonentëve të rrjetit të Vodafone Albania (102), Vodafone Albania ka të drejtë ta ndryshojë me një njoftim paraparak 7 (shtatë) ditor dërguar me shkrim Albtelecom.”
25. Vodafone shprehet për standart të dyfishtë që Albtelecom mban për sa i takon procedurës, pasi përgjatë vitit të kaluar Vodafone Albania sërish në përputhje me kuadrin kontraktual në fuqi ka njoftuar ndryshimin e tarifës së terminimit me efekt nga data 1 Shtator 2012 sipas një njoftimi paraparak 7 ditor, por kurrsesi nuk hasi në një reagim të tillë refuzues nga Albtelecom, por tarifa komerciale e dhënë nga Vodafone u pranua plotësisht. Ky standard i dyfishtë i sjelljes evidentohet kur Albtelecom e zbaton afatin 7 ditor ndaj të tretëve kur ata dëshirojnë të terminojnë trafik në rrjetin e Albtelecom.
26. Vodafone sqaron se, Albtelecom i referohet nenit 32.1 të MI “Ndryshimi i tarifave që nuk janë objekt rregullimi nga AKEP, hyjnë në fuqi pa miratimin e AKEP, për sa kohë AKEP nuk shprehet me vendim për mosmiratimin/pezullimin e ndryshimit të tyre” e cila i përket shërbimeve 106, 107, 108, por kjo nuk ka të bëjë aspak me tarifën e terminimit të trafikut ndërkombëtar refuar ORI të Vodafone (shërbimi i terminimit të trafikut ndërkombëtar nuk është më i përfshirë në ORI miratuar me VKD nr. 2179 datë 29.10.2012).
27. Vodafone sqaron se, pretendimet e Albtelecom mbi ‘moszbatimin nga Vodafone të procedurës së njohur dhe pranuar në Marrëveshje në rastet e mosmarrëveshjeve midis palëve’, janë plotësisht të pambështetura në ligj dhe në fakte, dhe mbi të gjitha deformuese me një qëllim të vetëm: të dëmtojnë imazhin e Vodafone dhe të përfitojnë në mënyrë të paligjshme dhe abuzive ndaj tij.
28. Vodafone sqaron se, pretendim i Albtelecom se zgjidhja e kontratës për shërbimin e terminimit të trafikut ndërkombëtar është bërë në mospërputhje me dispozitat kontraktuale, është plotësisht e gabuar dhe e pabazuar në fakte dhe ligj. Vodafone Albania ka bërë një propozim kontraktual, ndaj të cilit Albtelecom, mund t’i përgjigjej me pranim ose refuzim, në përputhje të plotë me dispozitat që parashikon Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 659 e në vijim.
29. Vodafone shprehet se, në kuptim të VKD nr. 2118, VKD nr. 2122 dhe kontratës në fuqi së bashku me amendamentet e nënshkuara midis palëve, si dhe në vijim të komunikimit formal dhe informal në lidhje me tarifën e shërbimit, Vodafone ka kryer negociata të plota me Albtelecom, në përputhje të plotë me kuptimin e dispozitave të Kodit Civil për lirinë kontraktuale dhe interesave reciproke të palëve.
30. Vodafone shpjegon se, në kushtet kur:
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë neni 663 sanksionon se *‘pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin është një nga kushtet e nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës’*.

- VKD nr. 2118, përcakton se dhënia e aksesit dhe tarifa e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në një rrjet celular është objekt i negociatave komerciale midis palëve; dhe,
- VKD nr. 1468 dhe ORI miratuar me VKD 2179 mbi të cilën është ndërtuar MI ekzistuese dhe amendamentet e saj 1, 2,3 dhe 4;
- Neni 20.5, pika 20.5.4 i Marrëveshjes (Shkelja, pezullimi dhe zgjidhja e MI), së bashku me nenet 1 dhe 2 të Amendamentit nr.1 dhe nenet 3 dhe 7 të Amendamentit nr. 3 të MI;

Të gjitha së bashku si bazë ligjore përcaktojnë domosdoshmërinë thelbësore për praninë të elementit “çmim” mes palëve përpara se një shërbim t’i mundësohet palës tjetër, çmim i cili nuk është pranuar dhe është refuzuar nga Albtelecom; në këto kushte Marrëveshja nuk zbatohet për shërbimin e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituara nga rrjeti i Albtelecom drejt abonentëve të rrjetit të Vodafone (shërbimi 102). Kjo i është njoftuar me shkrim subjektit Albtelecom, ashtu sic edhe parashikohet në nenin 20.5 të MI.

31. Vodafone shprehet se VKD nr. 2118 përcakton qartësisht se terminimi i thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin e operatorëve celularë është një treg jashtë rregullimit nga AKEP. Edhe VKD nr. 2122 datë 4.7.2012, AKEP ka vendosur që: “Detyrimet e Vodafone Albania sh.a. për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të përcaktuara në vendimin nr.1211, datë 31.03.2010 të Keshillit Drejtues të AKEP, dhe amendimet e tij, hiqen.”
32. Vodafone shpjegon se pretendimet e Albtelecom se ”tarifat e terminimit të trafikut ndërkombëtar ofruar Albtelecom të jenë të njëjta me ato të trafikut kombëtar” janë trajtuar dhe ezauruar në mënyrë shteruese dhe përfundimtare nga AKEP në përgjigjet për komentet e palëve gjatë shqyrtimit të Analizës së Tregut 2012. Kjo kërkesë për njëtrajtësim të tarifës së terminimit kombëtar me atë ndërkombëtar është sërish një qëndrim kontradiktor dhe diskriminativ i Albtelecom pasi pikërisht subjekti Eagle Mobile ka dërguar në adresë të Vodafone në datë 19.02.2012 shkresën me nr. 225 prot ku njofton Vodafone se do të aplikojë tarifën prej 21 Lek/min për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin e Eagle Mobile – ndërkohë që tarifa kombëtare e terminimit në rrjetin e Eagle Mobile në atë kohë ka qenë vetëm 8.85 Lek/min. Vodafone i kërkon AKEP të shqyrtojë me kujdes dhe rigorozitet, në zbatim të parimeve të paanshmerisë dhe barazisë këtë çështje nga fillimi deri në fund.
33. Vodafone shprehet për qëndrimin e Albtelecom se tregu nr. 7 sipas VKD nr. 2342 datë 31.07.2013 “nuk diferencon në treg terminimi të thirrjeve kombëtare apo ndërkombëtare”, cka është plotësisht kontradiktore me qëndrimin e tij të mëparshëm përgjatë Analizës së Tregut 2012. Por ky pretendim është shqyrtuar në mënyrë shteruese dhe përfundimtare nga AKEP në Analizën e Tregut Celular 2012.
34. Vodafone sjell në vëmendje të AKEP dhe të Albtelecom, qëndrimin e AKEP në VKD 1955/24.05.2012 pjesën arsyetuese të tij (mosmarrëveshje e ngjashme midis Neofone dhe Eagle Mobile, kur ky i fundit i ka njoftuar në mënyrë të njëanshme tarifën e re komerciale Neofone, tarifë e cila nuk është pranuar nga Neofone me arsyen se ishte e ndryshme nga tarifa kombëtare).

35. Vodafone shpjegon se ofron shërbimin e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin e tij për një sërë partnerësh lokalë dhe ndërkombëtare, mbi 10 të tillë, kështu që cdo pretendim për monopolizim të tregut është absurd.
36. Në lidhje me pretendimet e Altelecom përsa i takon “përgjashtimit të Altelecom nga e drejta e ligjshme e tij, apo shkeljen e të drejtave të licensave, etj”, Vodafone shpjegon se kjo është plotësisht e pavërtetë. Autorizimi i subjektit Altelecom, sic edhe i cilitdo operatori tjetër komunikimesh elektronike, legjitimon Altelecom për kryerjen e disa shërbimeve, dhe i mundëson Altelecom kapacitetin ligjor dhe rregullator vetëm për të konkurruar me ofruesit e tjerë në tregun e komunikimeve elektronike nëpërmjet ofrimit të këtyre shërbimeve.
37. Vodafone sjell në vëmendje, se pavarësisht se aksesit është në diskrecion të Vodafone për ta ofruar ose jo, për asnjë cast nuk e ka përgjashtuar Altelecom nga shërbimi i ofruar, por vetëm ka ndjekur me rigorozitet procedurat kontraktuale për ndryshimin e cmimit, sic më lart vërtetua. Tarifa ofruar Altelecom nuk është më e lartë se tarifa komerciale që i është ofruar partnerëve të tjerë carrier ndërkombëtarë pas negociatave përkatëse.
38. Vodafone shpjegon se përsa i përket caktimit të nivelit të tarifës, neni 53 i Ligjit 9918 që ju i referoheni e shpreh qartë se ajo është në diskrecion të palës që ofron shërbimin.
39. Vodafone shpjegon se në kuptimin e ligjit nr. 9123 datë 28.07.2003 Ligjit 9918 dhe akteve nënligjore, Analizës së Tregut 2012 (VKD nr. 2118), Vodafone Albania ju kujton se nuk mban pozitë dominuese apo status “monopolistik” në tregun përkatës ndaj dhe nuk mund të abuzojë me një pozitë që nuk e disponon.

Sa më sipër Vodafone Albania sh.a. kërkon nga AKEP:

1. Mos pranimin e ankimit administrativ të Altelecom sha (kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshje nga AKEP), për mungesë të kompetencës së shqyrtimit të çështjes dhe mbylljen e procedimit administrativ.
2. Revokimin e masës provizore.

III. Altelecom sh.a. me shkresën nr. 6360Prot, datë 11.10.2013, ka depozituar “*Pretendimet në zbatim të VKD nr. 2354, datë 27.9.2013, mbi fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me Vodafone Albania sh.a. për tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe refuzimin për ofrimin e shërbimit të aksesit dhe terminimit të trafikut ndërkombëtar*”.

A. Në lidhje me mosmarrëveshjen, Altelecom shpjegon se,

Me anë të shkresës me ref. CEO/113/MF, datë 16.9.2013, Vodafone ka njoftuar se duke filluar nga data 23.9.2013, tarifa e re e terminimit në rrjetin e Vodafone për thirrjet ndërkombëtare do të jetë në vlerën 27.4 lekë/min. Më datë 19.9.2013, Altelecom me anë të shkresës nr. 5644/1Prot. nuk e ka pranuar tarifën e re duke kërkuar të njëjtën tarifë terminimi pavarësisht nga origjina e thirrjes.

Më datë 20.9.2013, Vodafone me shkresën me ref. CEO/114/MF njofton Altelecom se duke filluar nga data 24.9.2013, nuk i mundëson Altelecom-it shërbimin e terminimit të trafikut ndërkombëtar dhe më datë 24.9.2013, ora 22:00 Vodafone ka bllokuar krejtësisht

kapacitetet e interkoneksionit të dedikuara për terminimin e trafikut ndprkombëtar të tranzituar nga Albtelecom.

Albtelecom, me anë të shkresës nr. 5880Prot, datë 25.9.2013, i drejtohet AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me Vodafone. AKEP me anë të VKD nr. 2354, datë 27.9.2013, ka vendosur fillimin e procedimit administrativ dhe në pikën 2 të tij ka urdhëruar Vodafone të vazhdojë marrëdhëniet me Albtelecom në lidhje me aksesin dhe tarifën e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin e Vodafone sipas marrëveshjes së palëve para lindjes së mosmarrëveshjes.

Në përputhje me sa më lart Albtelecom shpjegon se i ka kërkuar në rruge elektronike Vodafon-it zbatimin e VKD 2354, por Vodafone nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ta zbatuar atë.

Albtelecom shpjegon se, i është drejtuar AKEP me shkresën nr. 5880/1, datë 30.9.2013, me anë të së cilës e vë në dijeni se Vodafone vazhdon t'i mbajë të bllokuara kapacitetet e interkoneksionit për trafikun ndërkombëtar edhe pas marrjes së vendimit 2354.

Albtelecom me shkresë 5938/1, datë 1.10.2013 drejtuar Vodafone, i kërkon zbatimin e MI dhe amendimeve të saj, Rregullores për akses e interkoneksion, dhe ligjit nr. 9918.

Albtelecom shpjegon se nga Vodafone është depozituar shkresa me ref. CEO/117/MF, datë 1.10.2013, ku deklarohet se Vodafone nuk do ta zbatojë Vendimin e AKEP dhe e konsideron këtë akt administrativ absolutisht të pavlefshëm.

Albtelecom shprehet se Vodafone si palë në procedim ka detyrimin të zbatojë çdo vendim të marrë nga organi administrativ AKEP në përputhje me KPrA. Çdo pretendim i Vodafone për ligjshërinë apo rregullsinë e aktit të nxjerrë nga AKEP nuk mundet në asnjë moment të çenojë zbatimin e menjëhershëm të këtij akti administrativ.

Albtelecom shpjegon se AKEP me VKD nr. 2362,d atë 10.10.2013, ka rrëzuar ankimin e Vodafone, dhe kjo thekson edhe më shumë qëndrimin e kundraligjshëm të Vodafone në shkelje të dispozitave urdhëruese të AKEP dhe po ashtu edhe për mbajtjen e bllokuar të kapaciteteve të interkoneksionit.

B. Argumentet ligjorë, Albtelecom shpjegon se,

Rritja e tarifës nga ana e Vodafone në vlerën 27.4 lekë/min vjen në kundërshtim me një nga parimet kryesore të ligjit nr. 9918 që lidhet me orientimin e tarifave në kosto.

MI është amenduar disa herë dhe Amendamenti 3, datë 11.5.2013, neni 7.2 dhe neni 32.1 parashikojnë respektivisht: *...”Tarifat e shërbimeve të interkoneksionit mund të ndryshohen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9918 dhe kuadrin rregullator përkatës”....; ...”Ndryshimi i tarifave që nuk janë objekt rregullimi nga AKEP, hyjnë në fuqi pa miratimin e AKEP, për sa kohe AKEP nuk shprehet me vendim për mosmiratimin/pezullimin e ndryshimit të tyre” ...*

Albtelecom shpjegon se sa më sipër, Vodafone mund të ndryshojë tarifën e shërbimit të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituara nga Albtelecom drejt abonentëve të rrjetit Vodafone, me kusht që tarifa e ndryshuar të jetë në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9918, i ndryshuar dhe kuadrin rregullator përkatës. Albtelecom ka të drejtë të ankohet në AKEP për tarifën e ndryshuar. AKEP mund të vendosë të mos e miratojë këtë tarifë. Në këtë rast tarifa ekzistuese përpara lindjes së mosmarrëveshjes ose tarifa e vendosur nga AKEP, ngelet në fuqi.

Albtelecom shpjegon se për shkak të mosdakortësisë Vodafone i ka refuzuar terminimin e thirrjeve ndërkombëtare, 7 ditë pas propozimit të tarifës së re. Vodafone këtë e justifikon me nenin 20.5.4 të MI.

Neni 19.1 i MI shpjegon Albtelecom, parashikon si periudhë negociimi mes palëve 10 ditë nga data e njoftimit. Ndërsa 19.2, 19.4 dhe 19.5 parashikojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas rregullores për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në AKEP.

Albtelecom shpjegon se asnjë nen i MI nuk parashikon që Vodafone mund të zgjidhë në mënyrë të pjesshme MI sepse Albtelecom nuk pranon ndryshimin e njëanshëm të tarifës së terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.

Albtelecom shpjegon se, ndërprerja e shërbimit të terminimit të trafikut ndërkombëtar, bllokimi i kapaciteteve të interkoneksionit të dedikuara për terminimin e trafikut ndërkombëtar të tranzituar nga Albtelecom, është shkelje e flagrante e MI dhe Albtelecom është i vendosur të kërkojë dëmshpërblim e dëmeve të shkaktuar, duke përfshirë fitimin e munguar dhe dëmin e shkaktuar reputacionit dhe emrit të mirë tregtar. Albtelecom është dëmtuar edhe në lidhje me refuzimin e Vodafone për zbatimin e pikës 2 të Vendimit 2354, në lidhje me detyrimin për të vijuar marrëdhëniet e interkoneksionit sipas MI para lindjes së mosmarrëveshjes. Albtelecom shpjegon se është në vështirësi me partnerët ndërkombëtarë me të cilët ka marrëveshje biznesi.

Albtelecom shpjegon se Vodafone është i detyruar të ofrojë interkoneksion sipas ligjit nr. 9918, nenet 47, 48 e 49, si edhe referuar Rregullores së Aksesit e interkoneksionit, nenet 4 e 6. Ndërprerja e shërbimit të terminimit të trafikut ndërkombëtar dhe bllokimi i kapaciteteve të interkoneksionit jo vetëm në kundërshtim flagrant jo vetëm me ligjin po edhe kuadrin rregullator.

Albtelecom shpjegon se *“Rregullorja për analizën e tregut”* në pikën 7 përcakton *“Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale të lëvizshme”* është një i vetëm dhe nuk diferencohet nga origjina e thirrjeve të terminuara në përputhje me kuadrin rregullator europian.

Albtelecom shprehet se në Analizën e tregut 2012 ka vendosur se Vodafone përmbush kriteret e sipërmarrësit me FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin celular Vodafone (fq. 36). Pavarësisht kësaj AKEP vendosi të heqë masat rregullatore për rregullimin ex-ante të tarifës së terminimit të thirrjeve ndërkombëtare. Edhe historiku i masave të ndërmarra nga rregullatori në lidhje me tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, dëshmon se heqja e tyre ka ardhur si pasojë e vetregullimit të tregut dhe nuk ka nevojë për ndërhyrje.

Albtelecom shprehet se edhe MI e arritur me Vodafone dhe amendamentet e saj kanë qenë frut i negociatave mes palëve. Duke qenë se Vodafone e ka prishur këtë MI me propozimin e njëanshëm të tarifës së terminimit 6 herë më të madhe. Referuar nenit 53 i ligjit përcakton se *“...”* në përcaktimin e tarifave sipërmarrësit duhet të synojnë orientimin e tyre drejt kostos”.... këto tarifa nuk duhet të jenë abuzive, shpërdoruese dhe antikonkurrese.

Albtelecom shprehet se, tarifa 6 herë më e lartë e propozuar nga Vodafone është diskriminuese në kuptim të nenit 39 të ligjit nr. 9918 dhe nenit 9/2 të ligjit nr. 9121 (Për mbrojtjen e konkurrencës). Këto veprime kanë për qëllim rritjen e të ardhurave të Vodafone si operatori me më shumë përdorues dhe përfituesi kryesor.

Kjo shpjegon Albtelecom do të shoqërohet me rritjen e aftësisë ndikuese të Vodafone në tregun me pakicë të telefonisë zanore.

Albtelecom shpjegon se, imponimi nga Vodafone i një tarife shumë të lartë dhe jo të orientuar në kosto, si dhe refuzimi për të dhënë akses në shërbimin e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, ka si pasojë fuqizimin e mëtejshëm të pozitës dominuese të Vodafone, e daljen nga tregu të operatorëve të tjerë, shkatërrimin e konkurrencës së lirë në tregun e telekomunikacioneve.

Albtelecom shprehet se, njoftimi i tarifës prej 27.4 lekë/min nga Vodafone, ndërprerja e ofrimit të shërbimit të terminimit të trafikut ndërkombëtar të tranzituar nga Albtelecom dhe refuzimi i Vodafone për të zbatuar VKD nr. 2354, janë prova të mjaftueshme se Vodafone po thëllon më tej abuzimin e tregut me veprime të padrejta tregtare dhe antikonkurruese.

Albtelecom shpjegon se, ripërsëritja e precedentëve të 2010, ku Vodafone ndërpreu ofrimin e këtij shërbimi, është kërcënues për të gjithë aktoret në treg (*Albtelecom sjell në vëmendje VKD 1437, datë 3.11.2010*). Tashmë mbi Vodafone nuk rëndon vetëm ndërmarrja e veprimeve të përsëritura të padrejta tregtare, antikonkurruese, të njëanshme dhe të paligjshme, por edhe qëndrimi agresiv në mosnjohjen e mospranimin e Vendimeve të AKEP.

Albtelecom, në përfundim kërkon nga AKEP:

1. Të mos pranojë tarifën e shërbimit të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituar nga Albtelecom drejt abonentëve të rrjetit Vodafone të propozuar nga Vodafone prej 27.4 lekë/min;
2. Të vendosë që tarifa e shërbimit të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituara nga rrjeti i Albtelecom drejt abonentëve të rrjetit të Vodafone Albania, të jetë e barabartë me tarifën e përcaktuar nga AKEP për terminimin e thirrjeve kombëtare, duke filluar nga data 1.9.2013;
3. Të konstatojë sjelljen e paligjshme dhe abuzive të Vodafone Albania në lidhje me ndërprerjen e njëanshme të shërbimit të terminimit të trafikut ndërkombëtar;
4. Të marrë masa të menjëhershme për ekzekutimin e VKD nr. 2354, datë 27.9.2013, si edhe VKD nr. 2362, datë 10.10.2013, sipas përcaktimeve të KPrA, në mënyrë që Vodafone Albania të mos mund të vazhdojë abuzimin e tregut me veprime të padrejta tregtare dhe antikonkurruese, që kufizojnë apo pengojnë terminimin e trafikut ndërkombëtar në rrjetin e Vodafone.

Gjithashtu, Albtelecom sh.a. me shkresën nr. 5938/1, datë 1.10.2013, “*Mbi zbatimin e MI dhe VKD nr. 2354, datë 27.9.2013, mbi vijimin e ofrimit të shërbimit të interkoneksionit nga ana e Vodafone*” i kërkon Vodafone të zbatojë këtë vendim, duke marrë masat për rivendosjen e shërbimit dhe rihapjen e kapaciteteve të interkoneksionit.

Po sips Albtelecom sh.a , Vendimi i Vodafone për të moszbatuar VKD nr. 2354, përbën shkelje flagrante ligjore me pasoja të rënda financiare jo vetëm për periudhën e bllokimit të interkoneksionit por edhe me pasoja të rënda financiare në formën e fitimit të munguar dhe dëmtimit të imazhit të Albtelecom sh.a.

Albtelecom bën me dije Vodafone se në përputhje me legjislacionin shqiptar, aktet rregullatore të Republikës së Shqipërisë, Rregulloren për akses e interkoneksion, Albtelecom do të kërkojë dëmshpërblim financiar në rrugë gjyqësore për dëmet e

shkaktuara si pasojë e pezullimit të shërbimit të interkoneksionit për terminimin e trafikut hyrës ndërkombëtar në rrjetin e Vodafone që prej datës 24.9.2013.

IV. Në vijim të vendimit të lartpërmendur, Nisatel sh.p.k. si palë e interesuar në këtë mosmarrëveshje me shkresën nr. 5010/2Prot. datë 5.10.2013 (nr. 1678Prot.i AKEP, datë 9.10.2013) “Mbi kundërshtimin e Vendimit të AKEP nr. 2354, datë 27.9.2013”, bazuar në Rregulloren nr. 18, datë 11.6.2010, “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve” e ndryshuar, i kërkon AKEP-it ta njoftojë për ecurinë e këtyre procedurave dhe të marrë në konsideratë pretendimet si më poshtë:

- Tregu i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare i cili është objekt i mosmarrëveshjes, dhe çdo zhvillim lidhur me të prek në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat ekonomike dhe strategjike të kompanisë Nisatel, si ofrues i shërbimit të tranzitit ndërkombëtar në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Duke ndërhyrë në favor të Altelecom, në një marrëdhënie komerciale, AKEP po fuqizon dhe favorizon një konkurrente të drejtpërdrejtë të Nisatel dhe të çdo operatori tjetër.
- Nëse Altelecom favorizohet në një mënyrë të tillë, Nisatel kërkon që edhe ai të favorizohet, gjithashtu të detyrohet Altelecom dhe Eagle të lidhin marrëveshje interkoneksioni me Nisatel. Gjithashtu, Nisatel të përfitojë nga nga terminimi i trafikut ndërkombëtar në rrjetin e Altelecom dhe Eagle. Nisatel ka kërkuar ndërhyrjen e AKEP në lidhje me këtë por përgjigja e AKEP ka qenë se ky treg është i derregulluar.
- Nisatel thekson dakortësinë që tregu i thirrjeve ndërkombëtare të mos jetë i rregulluar, pasi përfitojnë të gjithë operatorët, si për tranzitim në rrjete të tjera, ashtu edhe për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin e tyre, si dhe përfiton buxheti i shtetit, rriten investimet në tregun e komunikimeve dhe sidomos punësimi. Nisatel shpjegon se AKEP duhet ta mbajë tregun të parregulluar dhe te mos favorizojë operatorët pasi dëmton ekuilibrin ekzistues, qoftë të tregut të telefonisë fikse ashtu edhe atë celular.

V. Vendimi nr.2354, datë 27.09.2013, përfshirë masën e ndërmjetme te parashikuar ne te, u ankimuan nga Vodafone në rrugë gjyqësore, si me poshte pershkruar:

-Më dt 17.10 2013, në AKEP është depozituar letërthirrja e Gjykatës së Shkallës së parë nga ku AKEP merr dijeninë e parë se para kësaj Gjykate është depozituar një kërkesë padi për pavlefshmëri të aktit administrative për të cilën Gjykata ka vendosur të mbajë proces gjyqësore me seancë përgaditore më dt. 21.10.2013, me palë ndërgjyqëse Vodafone Albania paditës dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, i paditur.

-Në procesin gjyqësor “në seancën përgatitore” të datës 21/10/2013, të shqyrtimit të çështjes civile, bazuar në nenin 59, nenin 180 dhe nenin 183 të KPrC, AKEP si *pala e paditur*, i kërkoi Gjykatës që të nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor sepse i përket juridiksionit administrativ për sa kohë pala e paditur (AKEP) si organi kompetent për shqyrtimin e mosmarrëveshjes kontrollit administrativ nuk është shprehur me vendim përfundimtar.

- Gjykata, pasi ka dëgjuar kërkesën dhe argumentat e palës paditese AKEP, per të nxjerre çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor me vendim të ndërmjetëm ka vendosur rrëzimin e kërkesës së palës së paditur (AKEP) për nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes dhe vazhdimin e gjykimit të çështjes nga kjo gjykatë.

- AKEP, si palë e paditur, nisur nga njoftimi verbal i komunikuar në seancë nga ana e Gjyqtarës të çështjes civile për vendimin e ndërmjetëm për rrëzimin e kërkesës së palës së paditur për nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes dhe vazhdimin e gjykimit të çështjes nga kjo gjykatë, bazuar në nenin 137 të Kodit të Procedurave Administrative, nenin 120 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe nenin 59 dhe 485 të Kodit të Procedurës Civile, ka ushtruar të drejtën e kundërshtimit të juridiksionit të caktuar nga vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, nëpërmjet investimit me Ankim të vecante në Gjykatën e Lartë, ku ka kërkuar:

“Prishjen e vendimit të ndërmjetëm të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për rrëzimin e kërkesës së palës së paditur për nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes Nr. Aktit 18098, datë 14/10/2013 si të pabazuar ligjërisht dhe nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor”

Gjykata e larte ende nuk eshte shprehur me Vendim mbi ankimin e vecante te investuar nga AKEP.

VI. AKEP, pasi eshte njohur dhe ka marrë në shqyrtim pretendimet e paleve sa më sipër, çmon të arsyetoje për mosmarreveshjen, se:

- AKEP në Analizën e tregut celular, të miratuar me VKD nr. 2118, datë 4.07.2012, ka arritur në përfundimin se terminimi i thirrjeve ndërkombëtare në një rrjet celular nuk është pjesë e tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjet celular. Në bazë të këtij përfundimi, vendimet përkatëse për shpalljen me FNT të operatorëve celularë, kanë hequr detyrimet e operatorëve celularë për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare. Ky detyrim është hequr edhe për sipërmarrësin Vodafone Albania me VKD nr. 2122 datë 4.7.2012, ku AKEP në pikat 6.3 dhe 6.4 të vendimit ka vendosur që:

- i. *Detyrimet e Vodafone Albania sh.a. për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të përcaktuara në vendimin nr.1211, date 31.03.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP, dhe amendimet e tij, hiqen.*
- ii. *Heqja e detyrimeve të cituar në pikën 6.3 më sipër bëhet efektive më 1.09.2012.”*

- Heqja e këtij detyrimi është reflektuar edhe në ofertat referencë të interkoneksionit (RIO) të operatorëve celularë të miratuara nga AKEP më 29.10.2012, përfshirë edhe RIO të Vodafone Albania të miratuar me VKD nr.2179, datë 29.10.2012.

- AKEP në Analizën e tregut të telefonisë fikse, të miratuar me VKD nr. 2336, datë 30.07.2013, ka arritur në përfundimin se terminimi i thirrjeve ndërkombëtare në një rrjet fiks nuk është pjesë e tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjet fiks. Në bazë të këtij përfundimi, vendimet përkatëse për shpalljen me FNT të operatorëve të telefonisë fikse për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre, nuk përfshijnë detyrime për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare. Ky detyrim është hequr edhe për Albtelecom me VKD nr. 2337, datë 30.07.2013, ku AKEP në pikat 6.3 dhe 6.4 të vendimit ka vendosur që:

- i. *Detyrimet e Albtelecom sh.a. për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të përcaktuara në vendimin nr.1348, date 26.07.2010, i amenduar, hiqen.*
 - ii. *Heqja e detyrimeve të cituar në pikën 6.3 më sipër bëhet efektive më 1.09.2013.”*
- *De-rregullimet e mësipërme janë kryer në vijim të de-rregullimit të tarifave të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare dhe në rrjetin fikse të Albtelecom, që hynë në fuqi më 1.02.2012. De-rregullimet e mësipërme nënkuptojnë që dhënia e aksesit dhe tarifa e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në një rrjet celular (apo edhe në një rrjet fikse) është objekt i negociatave komerciale midis operatorit terminues dhe operatorit tranzitues dhe sic është cituar në analizën e tregut celular në 2012, dhënia e aksesit për terminim të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare duhet të jetë edhe në interesin komercial të palës terminuese.*
 - *AKEP me VKD nr.2354, datë 27.09.2013, për fillimin e këtij procedimi administrative vendosi pranimin e ankimit të Albtelecom për zgjidhje mosmarrvëshje me Vodafone, duke qenë se bazuar në ankimin e depozituar përmbusheshin kushtet formale ligjore për pranimin dhe shqyrtimin e mosmarrvëshjes së lindur midis palëve nga autoriteti rregullator (AKEP).*
 - *AKEP vendosi njëkohësisht të urdhërojë masën e ndërmjetme për vazhdimin e marrëdhënieve midis Vodafone Albania dhe Albtelecom, sipas marrëveshjes midis palëve deri para lindjes së mosmarrvëshjes midis tyre, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga AKEP-i për zgjidhjen e mosmarrvëshjes. Kjo masë e vendosur synonte ruajtjen e ekuilibrave aktuale në treg deri në zgjidhjen përfundimtare të mosmarrvëshjes dhe në asnjë rast nuk paragjykonte mosmarrvëshjen.*

Pranimi nga AKEP i shqyrtimit të mosmarrvëshjes se ngritur dhe parashtruar para AKEP dhe vendosjes së masës së ndërmjetme u krye në kushtet e vleresimit të pretendimeve kryesisht nga ana formale e tyre dhe rendesise dhe personalitetit Juridik të palëve në mosmarrvëshje duke supozuar në vlerësimin tone edhe një dëmtim të mundshëm të interesave publike nga ndërprerja e ndodhur. Me publikimin e vendimit nr.2354, datë 27.09.2013, në AKEP ka depozituar pretendime edhe operatori Nisatel (referuar më sipër në pikën IV) duke kërkuar përfshirjen në proces dhe kundërshtimin njëkohësisht të nisjes së procedurës administrative të shqyrtimit nga AKEP pasi marrëdhëniet midis operatorëve dhe terminimi i thirrjeve ndërkombëtare duhet të vazhdojnë të jenë të parregulluara, duke mos bërë favorizime për operatorë të caktuar pasi kjo dëmton ekuilibrin ekzistues, qoftë të tregut të telefonisë fikse ashtu edhe atë celular.

- *Nga ecuria e procesit dhe nga sa AKEP administron vihet re se pavarësisht investimit të AKEP nga Albtelecom sh.a për zgjidhjen e mosmarrvëshjes në rrugë administrative dhe investimit të sistemit gjyqësor nga Vodafone Albania sh.a për mos-kompetencën e AKEP për këtë çështje, palët kanë vazhduar negociatat për zgjidhjen e mosmarrvëshjes në interes komercial të përbashkët. Ky fakt konstatues mbështetet edhe nga shkresa e Vodafone sh.a me referencë CEO/003/MF, datë 30.01.2014, dërguar Albtelecom.*

- AKEP, referuar precedentit administrativ te krijuar per raste të ngjashme me pale te ndryshme, duke shqyrtuar ceshtjet rast pas rasti sipas objektit te kerkimit dhe formalitetit te praktikave ankimuese ka bere vleresimin ligjor dhe ka çmuar mos fillimin e procedurave per zgjidhjen e mosmarrveshjes duke i orientuar drejt palët në gjetjen e zgjidhjeve me interes të përbashkët komercial midis palëve, zgjidhje qe plotesojne pretendimet dhe kerkimet e tyre.

AKEP, sa me siper gjykon që edhe për mosmarrëveshjen midis Albtelecom sh.a dhe Vodafone Albania sh.a, ne reference te plote dhe në vijim të vendimeve të marra për *de-rregullimin* e marrëdhënieve midis palëve për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, të orientojë palët ne mosmarrëveshje në zgjidhje me interes të përbashkët.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe piken 1 te nenit 115, të Ligjit nr. 9918 i ndryshuar, nenin 46 e vijues të K.Pr.A,

V E N D O S:

1. Mbylljen e procedimit administrativ të nisur me VKD nr.2354, datë 27.09.2013.
2. Ky vendim t'i njoftohet palëve të interesuara.
3. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE